

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 29 Prill 2005,

Me qëllim të përfshirjes së Nenit 11, 12 dhe 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20, ("Rregullorja e Pensionit"), për çështjen e parashikimit të standardeve dhe direktivave në transaksionin e investimeve të mjeteve të pensioneve dhe rolin (et), detyrat dhe obligimet e menaxherit(ve) të mjeteve.

Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 4 prill 2007 përshtat si vijon:

Rregulla 10 mbi ndryshimin e rregullës për Menaxherët e Pronave të Mjeteve të Pensioneve

Neni 1 Sfera dhe Qëllimi i Rregullës

1.1. Sfera e Rregullës

Kjo rregull i adresohet Menaxherit të Mjeteve të mjeteve të pensioneve të Trustit të Pensioneve të Kursimit në Kosovë ("Trusti"), Pensioni Suplementar Punëdhënës (Fondi i Pensionit) dhe, aty ku aplikohet, Pensioni Individual Suplementar (Siguruesi i Pensioneve).

1.2. Qëllimi i Rregullës

Kjo rregull përshkruan disa direktiva të caktuara për investimet e duhura të mjeteve të pensioneve sipas dispozitave të Nenit 11, 12 dhe 17 të Rregullores së Pensionit.

Neni 2 Dispozitat e Përgjithshme

2.1 Definimi

Te gjitha termat e shfrytëzuara në këtë Rregull janë ashtu siç janë të definuar në Rregulloren e Pensionit.

“Marrëveshja e menaxhmentit të mjeteve” i referohet marrëveshjes, me çfarëdo emri që quhet, ndërmjet Trustit, trupit drejtues të Fondit të Pensionit ose Siguruesit të Pensionit, aty ku aplikohet, dhe Menaxherit(et) të Mjeteve në lidhje me menaxhmentin dhe investimin e mjeteve të pensioneve.

“Menaxhmenti i mjeteve” përfshin ofrimin e këshillave për investim dhe transaksion të investimeve të tilla, të pakufizuara për kërkesën, burimin, negocimin, përvetësimin, shkëmbimin, ruajtjen dhe dispozimin e mjeteve të pensioneve dhe kontabilitetin e këtyre rezultateve, duke përfshirë zhvillimin e projektit të investimit të mjeteve të investuara aktuale apo të propozuara.

“Principet e investimit” i referohen politikës së investimeve dhe objektivave të zhvillimit të investimeve të përshtatura nga entiteti i pensionit për investimin e mjeteve të pensioneve qoftë të shprehura në Urdhëresën e Pensionit, Rregullat e Pensionit ose në direktivat e investimit.

“Direktivat e investimit” i referohen urdhrave ose udhëzimeve të bëra nga entiteti i pensionit për menaxherin(et) e mjeteve duke specifikuar termet, kushtet dhe mënyrën e transaksionit të investimeve të mjeteve të pensioneve.

“Entiteti i pensionit” përfshin Trustin, Fondin e Pensionit dhe aty ku aplikohet Siguruesin e Pensionit.

Neni 3

Kushtet për drejtimin e Biznesit të Menaxherit të Mjeteve

3.1 Menaxheret e Mjeteve të vendosur në Kosovë

Një menaxher i mjeteve i cili është i vendosur në Kosovë duhet të plotësojë të gjitha kushtet siç vijojnë:

- a) Forma e organizimit dhe licenca. Banka ose institucioni financiar që është entitet ligjor në Kosovë dhe i licencuar si i tillë nga AQBK-ja, i autorizuar në pajtim me kërkesat e rregullores bankare dhe të Rregullës 4 të këtyre Rregullave dhe të zhvillojë biznesin e menaxhmentit të mjeteve.
- b) Përshtatja me Rregulloret e Pensionit, Rregullat e AQBK-së mbi Pensionet dhe ligjet tjera të aplikueshme, statutet, rregulloret dhe rregullat. Një menaxher i pronave mendohet të pajtohet dhe të vazhdojë të pajtohet që të përshtatet me dispozitat e Rregullores së Pensionit, këtyre Rregullave dhe ligjet tjera, rregulloret ose rregullat e lëshuara nga autoritetet kompetent në Kosovë që ndikon në menaxhmentin e mjeteve të pensioneve.

- c) Përgjegjësit fiduciare. Një menaxher i mjeteve pranon detyrat fiduciare dhe përgjegjësitë e entitetit të pensionit të pjesëmarrësve dhe përfituesve për menaxhment të mençur të mjeteve të tyre të pensioneve. Kjo detyrë fiduciare dhe përgjegjësi mendohet të përfshihet në çdo marrëveshje të menaxhmentit të mjeteve në relacion me mjetet e pensioneve.
- d) Shpërndarja e mjeteve të pensioneve. Një menaxher i mjeteve duhet të mbaj, administroj, mbaj evidencë, numëroj dhe bëj raporte mbi mjetet të cilat janë nën menaxhmentin e tij veçante prej secilit entitet të pensionit dhe prej të gjitha llogarive të tjera të menaxhmentit të mjeteve që ka me personat tjerë dhe entitetet.
- e) Roli mbikëqyrës dhe rregullator. Një menaxher i mjeteve, dhe të gjithë drejtorët e tij, oficeret, nëpunësit dhe/ose ndonjë person që ushtron, ose do të ushtronte ndonjë funksion në relacion me menaxhmentin e mjeteve të pensioneve pajtohet dhe vazhdon të pajtohet që të nënshtrojnë veten nën mbikëqyrjen dhe rregullimin direkt të Departamentit të Pensionit në AQBK në lidhje me zhvillimin e biznesit si menaxher i pronave të mjeteve të pensioneve.

3.2 Menaxheret e Mjeteve që ndodhen jashtë Kosovës

- a) Licencimi. Menaxheret e Mjeteve që ndodhen jashtë Kosovës duhet të licencohen nga rregullator të shërbimeve bankare ose financiare ose të tregjeve kapitale në shtetet anëtare të BE-së apo OECD-se dhe duhet të sigurojnë evidence të një licence të tillë për Trusin dhe AQBK-ne.
- b) Përshtatja me ligjet e aplikueshëm. Një menaxher i mjeteve që ndodhet jashtë Kosovës duhet të pajtohet me ligjet dhe rregulloret e aplikueshëm në autoritetin ku janë licencuar dhe duhet të sigurojnë evidence që është në qëndrim të mirë me autoritetin relevant.
- c) Shpërndarja e mjeteve të pensioneve. Një menaxher i mjeteve duhet të mbaj, administroj, mbaj evidence, numëroj dhe bëjë raporte mbi mjetet nën menaxhmentin e tij, veçantë prej secilit entitet të pensionit dhe prej të gjitha llogarive të menaxhmentit të mjeteve që ka me personat tjerë të entitetit.

Neni 4

Biznesi i një Menaxheri te Pronave

4.1. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Ne menaxhmentin e mjeteve te pensionit menaxheri i mjeteve duhet te veproj si vijon:

a)Te menaxhoj mjetet e pensioneve vetëm ne pajtim me deklaratën e principeve te adaptuara te investimit, dhe direktivat e lëshuara te investimeve nga entiteti i pensionit qe janë ne pajtim me kërkesat e Rregullores se Pensionit dhe Rregullës 9 te këtyre Rregullave.

b)Te ekzekutoj investimet e mjeteve te pensionit vetëm përmes kujdestarit te autorizuar.

c)Te mbaj shënime përkatëse te transaksioneve, investimin e mjeteve te pensioneve duke siguruar rruge adekuate te të gjitha transaksioneve te investimeve.

d)Te mbaj kopjet e dokumenteve për shlyerje qe shoqërojnë ndonjë transfer, lëshim ose përvetësim te fondeve dhe letrave me vlere qe përbejnë mjetet e pensioneve dhe te verifikoj se këto dokumente korrespondojnë me udhëzimet e tyre themelore, kërkesat ose marrëveshjet me kujdestarin.

e)Te siguroj te gjitha informatat e kërkuara nga entitetet e pensioneve me te cilët ka marrëveshje për menaxhment te mjeteve pasi qe janë te nevojshme për këto entitete qe te përshtaten me kërkesat e Rregullores se Pensionit, këto Rregulla dhe ligjet tjera te aplikueshme, statutet, rregullat ose rregulloret nga autoritetet kompetent.

f)Te siguroj se çdo marrëveshje, kërkesë ose instruksion qe behet me kujdestarin, Trustin, trustet, administratoret e entiteteve te pensionit për menaxhmentin e mjeteve te pensionit, te jene konform me termet dhe kushtet e deklaratës(ve) themelore te principeve te investimit dhe direktivave te investimit qe përshtaten me kërkesat e parashtruara ne Rregulloren e Pensionit dhe Rregullën 9 te këtyre Rregullave për investimet e mjeteve te pensioneve.

g) Te siguroj se ka themeluar një sistem adekuat dhe efektiv te kontrollit te brendshëm për menaxhmetin e mjeteve te pensionit.

h) Ti raportoj me përpikëri Trustit, Fondit te Pensionit dhe/ose Siguruesit te Pensionit nëse aplikohet, ndonjë investim te mjeteve te pensionit qe beson se thyen ose shkel kërkesat e Rregullores se Pensionit, këtyre Rregullave, ligjeve tjera te aplikueshme, statutet, rregulloret ose rregullat ne relacion me mjetet e pensioneve nen menaxhmentin e tij, ose duke pasur parasysh kryerjen si duhet te detyrave te tij fiduciare.

i) Te përgatis raporte te rregullta për Trustin, Fondin e Pensionit, dhe, aty ku aplikohet, Siguruesin e Pensionit, i kërkuar sipas termeve te marrëveshjes se menaxhmetit te mjeteve me një kopje për AQBK-ne ne te njëjtën mënyre dhe kohe sikur qe janë dërguar ne entitetin e pensionit.

j) Te raportohet me përpikëri ne Trust, (Fondit te Pensionit dhe Siguruesit te Pensionit, nëse aplikohet) dhe ne AQBK çdo informacion qe mund te vijë prej njohurive qe rrezikojnë ose mund te rrezikojnë sigurinë e mjeteve te pensionit për shkak te akteve ose shmangieve qe janë atribut i Bordit Drejtues te Trustit ose trupi drejtues i ndonjë Fondi te Pensionit, administratorit, kujdestarit, ose ndonjë personi qe ka liri veprimi dhe/ose kontroll ne menaxhmentin dhe kujdestarin e mjeteve te pensionit duke përfshire çdo informate te pafavorshme ne lidhje me personat e tille qe kane ekspozuar, ekspozojnë ose mund te ekspozojnë mjetet e pensioneve ndaj rrezikut te panevojshëm te humbjeve dhe/ose te çdo kushti qe sugjeron thyerjen ose shkeljen e Rregullores se Pensionit, te këtyre Rregullave ose ndonjë detyre fiduciar apo ligjore ose obligimi.

k) Te raportoj me përpikëri dhe direkt ne AQBK çdo informacion, te njohur nga ai, qe involvon ose sugjeron mashtrim, pandershmëri ose keqpërdorim te mjeteve te pensioneve qe i atribuohen ndonjë entiteti apo personi; ose kur Bordi Drejtues i Trustit ose trupat drejtues te çdo Fondi te Pensioni dështon, ose besohet me arsye se do te ketë dështim, ne adresimin ose ndërmarrjen e aksioneve përmirësuese për te sanuar thyerjen ose shkeljen e njohur te ndonjë detyre ligjore dhe fiduciare te kërkuar nga Bordi Drejtues, administratori(et), kujdestari(et), ose personave tjerë qe kane liri veprimi dhe kontroll ne mjetet e pensioneve.

Neni 5

Marrëveshja për Menaxhment të Mjeteve

5.1 Kërkesat e Marrëveshjes

Asnjë menaxher i mjeteve nuk mund të ndërmarr aktivitete të menaxhmentit të mjeteve të pensionit nëse nuk ka marrëveshje për menaxhmentin efektiv dhe ekzekutues të mjeteve, me Trustin (Fondin e Pensionit ose Entitetin e Pensionit, aty ku aplikohet).

5.2 Forma dhe përmbajtja e një marrëveshje të menaxhmentit të mjeteve

Çdo marrëveshje e menaxhmentit të mjeteve duhet të jetë me shkrim, e nënshkruar dhe e datuar nga oficeret që janë të autorizuar me vendimin e bordit, të bordit drejtues të entitetit të pensionit dhe menaxheri i pronave duke përcaktuar minimumin e kërkesave të veçanta si vijojnë:

- a) Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të menaxherit të mjeteve.
- b) Mënyra se si menaxheri i mjeteve kryen detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- c) Udhëzime specifike për votimin (përkrahjen) e aksioneve
- d) Pagesa e menaxherit të mjeteve dhe mënyra me të cilën këto taksa dhe tatime janë caktuar nëse janë pajtuar si përqindje të mjeteve të pensioneve nën menaxhmentin.
- e) Procedurat dhe kërkesat për përfundimin e marrëveshjes.
- f) Sanksionet që do të imponohen për menaxherin e mjeteve për thyerje dhe shkelje të termave dhe kushteve të marrëveshjes.

Neni 6

Investimet nëpërmes “Open-End Vehicles”

6.1. E aplikueshme për Trustin

Nëse Bordi Drejtues i Trustit vendos që të investoj disa ose të gjitha mjetet e pensionit nëpërmes “Open-End Vehicle”, kërkesat në vazhdim zbatohen:

- a) Forma e organizimit dhe licenca. “Open-End Vehicle” duhet të operohet, menaxhohet dhe themelohet nga banka, kompanitë e sigurimit ose institucioni financiar që është entitet ligjor në njërin nga shtetet OECD dhe është licencuar nga rregullatori i tregut financiar në pajtim me kërkesat e ligjit të aplikueshëm dhe

rregulloren për të zhvilluar biznesin e menaxhmentit të mjeteve nëpërmes të “Open-End Vehicle”.

b) Përgjegjësitë fiduciare të Bordit. Përcaktimi se nëse është optimale të shfrytëzohet “Open-End Vehicle” ndryshe nga disa forma tjera të menaxhmentit është përgjegjësi fiduciare e Bordit Drejtues, duke marrë parasysh kualitetin e investimit, shumën e mjeteve nën menaxhment, shpërndarjen e mjeteve dhe koston e menaxhmentit. Zgjedhja e “Open-End Vehicle” duhet të shkojë në pajtim me kriteret e zgjedhjes të rregulluara më parë në Rregulloren e Pensioneve.

c) Përgjegjësitë fiduciare të “Open-End Entity” pretendon detyrat fiduciare dhe përgjegjësitë për Trustin dhe pjesëmarrësit dhe përfituesit për menaxhment të mirë të Mjeteve të Pensionit.

d) Procesi i seleksionimit. Bordi Drejtues duhet të seleksionoj një “Open-End Vehicle” që adapton dhe aplikon politikën e investimeve në përputhje me deklaratën e parimeve të investimeve të Trustit dhe nga të cilat në mënyrë të arsyeshme do të pritej që të pajtohen me kufizimet tek klasat e investimeve të Nenit 10 të Rregullores së Pensionit.

e) Shqyrtimi Periodik. Kjo do të jetë detyrë e Bordit Drejtues që në mënyrë periodike të shqyrtoj investimet e përbashkëta (“pooled investment”) të Open-End Vehicle dhe të vlerësoj përshtatjen e tyre të përgjithshme me principet e investimeve të saja të publikuara si dhe klasën e mjeteve dhe kërkesat e shpërndarjes të Nenit 10 të Rregullores së Pensionit. Bordi Drejtues duhet të raportojë rezultatet e shqyrtimit të tillë në AQBK në mënyrë të rregullt, jo më rrallë se një herë në tre muaj. Shmangia e vazhdueshme dhe e qëndrueshme nga direktivat e tilla nga Open-End Vehicle do të jetë baze për rishqyrtimin e përshtatshmërisë së investimeve. Devijimet e tilla nuk do të jenë thyerje e përgjegjësisë fiduciare të Bordit Drejtues. Mirëpo nëse devijimi zgjatë për gjashtë muaj prej datës së zbulimit ose nëntë muaj prej datës së devijimit (cila do të jetë me e shkurtër) Bordi do të ndër marr hapa të tërheq nga Open-End Vehicles dhe të zgjedh një menaxher të investimeve ose të tjetër fond (“pooled fund”) që janë konform me Rregullën e Pensionit.

f) Kontabiliteti i veçantë për mjetet e pensioneve të Trustit. Një “Open-End Vehicle” duhet të mbajë shënime dhe të raportojë mbi mjetet e përbashkëta (“pooled assets”) nën menaxhmentin e tij dhe duhet të shndërrojë kontabilitetin mbi aksionet e mjeteve totale të përbashkëta (“pooled assets”) (ose numrin e njësive në “pool”) që posedohen nga Trusti.

g) Kujdestari. Bordi Drejtues do të ndër marr hapa që të sigurojë se entiteti “Open-End” ka themeluar një sistem adekuat dhe efektiv të kontrollit të brendshëm për kujdestarinë dhe menaxhmentin e mjeteve të përbashkëta “pooled assets”, dokumentimi i të gjitha blerjeve dhe shitjeve dhe të transaksioneve të ngjashme.

Prej Bordit Drejtues te Trustit nuk do te kërkohet te zgjedh një kujdestar te pavarur për këto pasuri te pensioneve te Trustit qe janë investuar ne “pooled basis” nëpërmes te blerjes se aksioneve te mjetit “Open-End Vehicle”. Trusti mund te mbështetet ne Kujdestarin e mjetit “Open-End Vehicle” duke siguruar se kujdestari i Open-End Entity mban kontroll te veçantë prej Menaxherit te Mjeteve. Prej Trustit do te kërkohet te mbaj te gjitha shënimet ne lidhje me investimet ne mjetet “Open-End Vehicle” duke përfshire te gjitha shtesat ose zbritjet prej mbajtësit te Trustit.

h) Dëshmi te licencimit. Entiteti “Open-End” duhet ti siguroj Trustit evidence se është i licencuar për biznesin e tij ne mënyre te duhur sipas ligjeve te shteteve anëtare te OECD-se dhe se licenca e tille nuk është nen pezullim apo i është ndaluar veprimtaria.

i) Transferat. Bordi Drejtues duhet po ashtu te themeloj procedurat duke siguruar se te gjitha transferat e mjeteve nga entiteti “Open-End” duhet te behet sipas vendimeve si duhet te Bordit Drejtues dhe për pagesat e pensionit dhe shpenzimet.

6.2 Forma dhe Konteksti i Marrëveshjes me Trustin

Asnjë “Open-End Vehicle” nuk do te ndërmarr aktivitete te menaxhmentit te mjeteve te pensioneve nëse nuk ka marrëveshje te menaxhmentit efektiv dhe ekzistues me Trustin, te nënshkruar dhe te datuar nga oficeret qe janë te autorizuar me vendimin e bordit te Bordit Drejtues te Trustit dhe nga personat e autorizuar te “Open-End Vehicle”, duke përfshire ne vijim:

- a) Detyrat dhe Përgjegjësitë e “Open-End Vehicle”, kushtet për blerjen e aksioneve dhe klasat e mjeteve te përdorur si dhe çfarëdo kufizime pas asaj.
- b) Procedurat për kujdestari te mjeteve dhe identiteti i kujdestarit te automjeteve “Open-End Vehicle”.
- c) Pagesa e “Open-End Vehicle” dhe mënyra me te cilën këto taksa dhe tatime janë caktuar si përqindje e mjeteve te pensioneve nen menaxhment.
- d) Procedurat dhe kërkesat për ndërprerjen e marrëveshjes.
- e) Sanksionet qe duhet te ngarkohen ne “Open-End Vehicle” për thyerje ose shkelje te termeve dhe kushteve ne marrëveshje.

Ne përshtatje me Nenin 12.5 të Rregullores së Pensionit, Trusti mund të ekzekutojë dokumentin standard të abonimit të "Open-End Vehicle".

6.3 Te aplikueshëm për Fondet e Pensioneve dhe Siguruesve të Pensioneve

Fondet e Pensioneve, ose nëse janë të aplikueshëm, Siguruesit e Pensioneve duhet të emërojnë Menaxher(et) e Mjeteve në përshtatje me këtë Rregull.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të rregullës 10 shfuqizohet rregulla 14 mbi Investimet e Pasurive të Pensioneve të Trustit të Kursimeve të Pensioneve të Kosovës nëpërmes "Open End Entities".

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregull do të hyjë në fuqi më 16 Prill 2007.

Michel Svetchine
Drejtori i Përgjithshëm